



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KONKURRENCES

Njoftim për shtyp

“Për disa rekomandime mbi dokumentin e AKEP “Analiza e tregut celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”

Në mbledhjen e datës 23/09/2009, Komisioni i Konkurrencës shqyrtoi dokumentin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare,(AKEP) “Analiza e tregut celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”.

Autoriteti i Konkurrencës vlereson bashkepunimin me AKEP dhe marrjen në konsideratë të rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit Nr. 61, datë 21.11.2007 ‘Për disa rekomandime në tregun e telefonisë së lëvizshme’

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson punën e Rregullatorit mbi analizën e tregut, konkluzionet e draftuara dhe propozimet për ndërhyrje të mëtejshme në rregullimin administrativ të tregut të komunikimeve elektronike të paraqitura në dokumentin “Mbi analizën e tregut celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”.

Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f dhe nenin 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, vendosi t’i **rekomandojë** AKEP:

I. Aplikimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave jo vetëm për shërbimin me parapagesë, por edhe për shërbimin me kontratë; mesazhet elektronike (sms) dhe shërbime të tjera.

II. Aplikimin e “Metodologjisë së rregullimit të tarifave të terminimit” derisa tarifat e telefonisë celulare të jenë të krahasueshme me mesataren e tarifave që aplikohen në vendet e Bashkimit Europian.

III. Dhënien e licencës së re në tregun e telefonisë së lëvizshme ta shoqërojë me marrjen e të gjitha masave të nevojshme për ta bërë sa më shpejt efektiv operatorin e katërt, me synim rritjen e konkurrencës në treg.

IV. Shqetësimet e AKEP mbi nivelin e konkurrencës në tregun e telefonisë duhet t'i përcillen Autoritetit të Konkurrencës, pasi të jetë miratuar raporti përfundimtar nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP, me të gjitha elementet e provave dhe fakteve që disponon Rregullatori në mbështetje të nenit 61, pika 2 të ligjit "Për komunikimet elektronike".